



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gilan Beledijesi

Në bazë nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, lidhur me neni 15 paragrafi. 1 dhe 2 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin civil, Njësia për Personel në mbështetje të kërkesës së aprovuar nga MAP-DASHC për fillimin e rekrutimit shpall këtë :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Drejtoria Komunale e Arsimit

Titulli i pozitës : Zyrtar i Arsimit Parashkollor

Nr. i ekzekutuesve 1 (një)

Numri i referencës : JP00002028

Grada / Koeficienti: 7

Lloji i emërimit : i karrierës

Orari i plotë : 40 orë në javë

Qëllimi i vendit të punës : hartimi, zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit , politikave ,procedurave standarde lidhur me arsimin dhe edukimin në institucionet parashkollore, duke punuar me mbikëqyrje të kufizuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me shefin e sektorit të arsimit harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave .
- Analizon legjislacionin, politikën dhe procedurat lidhur me arsimin parashkollor dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve cilësorë në arsimin parashkollor.
- Ndihmon në hartimin dhe zhvillimin e legjislacionit , politikave , strategjive dhe procedurave standarde si dhe dokumentet tjera për arsimin parashkollor
- Monitoron mbarëvajtjen dhe zhvillimin e edukimit dhe arsimit parashkollor në përputhje me dokumentet strategjike të MASHT-it
- Mbështet dhe këshillon institucionet e arsimit parashkollor për gjithë përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm edukativ.
- Analizon programet dhe modulet që aplikohen për akreditim në edukimin parashkollor dhe rekomandon përmirësimin e tyre
- Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit dhe strategjive për arsimin parashkollor dhe harton raporte periodike dhe sipas nevojës për procesin e zbatimit të legjislacionit dhe strategjive për arsimin parashkollor
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.
- Për punën e kryer jep llogari mbikëqyrësit të institucioni përkatës.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera :

- Përgatitja profesionale : Diplomë Universiteti, Fakulteti -Programi Parashkollor ose Fakulteti i Pedagogjisë
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit në fushën e arsimit
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathtësi dhe njohje kompjuterike.

Për vendin e punës të cekura më lartë zbatohet puna provuese prej dymbëdhjetë (12) muajve konform nenit 20 paragrafi 2 të LSHCK lidhur me nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për punën provuese të nëpunësve civilë.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (foto kopje) si vijon :

1. Dëshmi mbi përgatitjen profesionale - kualifikimin fotokopje e vërtetuar te noteri, ndërsa e nostrifikuar në MASHT nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës,
2. Dëshmi mbi përvojën e punës
3. Certifikatat për trajnime dhe njohje të punës me kompjuter,
4. Dokumentin e identifikimit,
5. Certifikatën se nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale,

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike gazetë zyrtare, web faqen e Komunës dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim me shkrim dhe intervistë.

Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç parashihet në nenin 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.